



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:176679

Datë: 16.10.2020

Numri i dokumentit: 01194920

C.nr.732/19

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Venhar Salihu, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët porotë Abdyl Kadriu dhe Shaqir Hyseni, anëtar të trupit, në çështjen juridike të paditësit S.R nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim Faruk Brestovci, avokat nga Gjilani kundër të paditurës F. I. nga Burgasi, Rep. e Bullgarisë, tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Irfan Thaqi avokat nga Gjilani, me objekt kontesti zgjidhjen e martesës me padi për shkurorëzim, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jo publik të datës 15.10.2020, jashtë seancës në të njejtin datë morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. ZGJIDHET MARTESA** e lidhur më datë 15.04.2016, në Zyrën e Gjendjes Civile në Fsh.Hogosht, e regjistruar me numër rendor 23, numër të referencës 10/2016RM/10003, në mes të paditësit S. R. i lindur me datë..., nga babai A. R. dhe nëna N. R., dhe të paditurës F. I, e lindur me datë ...në Rep. Të Bullgarisë, nga babai S. I nëna S. I.1
- II.** Përfaqësues të përkohshëm Irfan Thaqi avokat nga Gjilani nga depozita civile do t'i paguhet shuma prej 239 €, kurse paditësit S. R. përkatësisht të autorizuarit të tij do t'i kthehet shuma 131.40 €.

**A r s y e t i m i**

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padi për zgjidhjen e martesës, duke theksuar se pas kurorëzimit, fillimisht raportet bashkëshortore të palëve kanë qënë të harmonizuara dhe në respekt të plotë, kur e paditura pas një kohe ishte kthyer në Bullgari tek familja e saj, kurse paditësi S. R. ka mbetur në shtëpinë e tij në Gjilani. Ata vazhdimisht kanë pasur kontakt ndërmjet tyre dhe nuk kanë vërejtur ndonjë problem në mes të njejtëve. Mirëpo me kalimin e kohës kanë filluar mosmarrveshjet ndërmjet tyre dhe kanë provuar që këto mosmarrveshje t'i tejkalojnë me mirëkuptim por duke pasur parasysh karakteret dhe edukatave të njejtëve, përpjekjet kanë dështuar në tërësi, andaj faktikisht jeta bashkëshortore ka humbur kuptimin e saj dhe i njejtë në vitin 2016 kishte shkuar në Bullgari në familjen e të paditurës për të biseduar me prindërit e saj dhe është informuar që e paditura nuk jeton në shtëpinë e prindërve të saj. Për arsyet e cekura më lartë paditësi S. R. ka paraqitur padi për shkurorëzim të martesës me dt.16.08.2019.

Sa i përket të paditurës gjykata nuk ka mundur të komunikojë me të dhe ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore, më konkretisht nenit 79.1, 79.3, nënpika (a) dhe (b), lidhur me nenin 81.1 dhe 83 të LPK-së, dhe me dt.01.09.2020, jashtë seancës gjyqësore është caktuar

Av.Irfan Thaqi nga Gjilani, si përfaqësues i përkohshëm I të paditurës dhe I njejt vendim është afishuar në tabelën e shpalljeve dhe është publikuar në Gazetën zyrtare të RKS-së.

E paditura brenda afatit të paraparë ligjor, më konkretisht me dt.29.09.2020 ka paraqitur përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës paditësi si të pabazuar dhe të pa argumentuara, përfaqësuesi I përkohshëm I të paditurës ka theksuar se sipas tij kemi të bëjmë një rrethanë të pakjartë pasi që I njejt thekson se paditësi në muajin dhjetor 2015 është njoftuar me të paditurën në Bullgari dhe se e paditura ka ardhur disa herë në Gjilan tek paditësi. Përfaqësuesi I të paditurës ka propozuar që të degjohen dëshmitarët të cilët në atë kohë kanë qenë prezent apo në ndonjë mënyrë kanë dëgjuar për lidhjen e martesës, por I njejt nuk ka cekur asnjë emër të dëshmitarëve. Po ashtu përfaqësuesi I të paditurës potencoi se nuk ka asnjë provë se paditësi ka shkuar në Bullgari që t'a takojë tani të paditurën, me arsyetimin që t'i sqarojë mosmarrëveshjet ndërmjet tyre, meqë paditësi thekson se për shkak të karaktereve të ndryshme ka dështuar edhe qëllimi I lidhjes martesore. Gjithashtu në përgjigjen në padi, përfaqësuesi I të paditurës ka theksuar se paditësi nuk ka prezentuar asnjë dokument të shkruar apo provë materiale e cila do të vertëtonte që në muajin dhjetor të vitit 2016 e tutje ka pasur bashkëjetesë të vazhdueshme me tani të paditurën, kusht ky për të qenë një martesë e vlefshme sipas dispozitave të LFK-së

Sa i perket tentim pajtimit, gjykata nuk ka mundur te tentoje qe te arrij pajtimin ndermjet paleve ndergjyqese, per shkak se adresa e te paditures nuk ka qene e njohur.

Me dt.15.10.2020, ne lidhje me kete ceshtje eshte caktuar séance pergatitore ku jane ftuar ne menyre te rregullt palet ndergjyqese dhe në bazë të nenit 420.3 të LPK-së, eshte vazhduar me seancen kryesore.

I autorizuari I paditësit në seancen pergatitore, kryesore dhe në spjegimet përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiisë për zgjidhjen e martesës, duke kërkuar nga gjykata që martesë e dt.15.04.2016 e lidhur në ZGJC , të zgjidhet, pasi që janë përmbushur kushtet ligjore për zgjidhjen e saj.

Përfaqësuesi I përkohshëm në seancen pergatitore, kryesore dhe në spjegimet përfundimtare ka mbetur pranë përgjigjes ne padi dhe nga gjykata ka kërkuar që të vendosë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme në lidhje me këtë çështje. I njejt ka kerkuar shpenzimet e procedures ka kerkuar ne shume prej 239 € edhe ate 104 € per përgjigje ne padi dhe shumen prej 135 € per nje seance.

Gjykata per te vepruar drejte dhe vertetuar gjendjen faktike ka administruar Çertifikatën e Martesës me nr.referencës 10/2016RM/10003, të datës 15.04.2016, dhe ka degjuar paditesin ne cilesi te pales.

Paditesi i degjuar ne cilesi te pales ne mes tjerash ka deklaruar : se me te paditurën jam njoftuar në Bullgari (përkatesisht në qytetin e Burgasit), ku aty kemi krijuar një lidhje dhe të njëjtën nen vitin 2016 e kam ftuar në Kosovë që të vi e të jetoj me mua, përkatësisht në shtëpinë time ne Gjilan. Në muajin tetor të vitit 2016 e paditura ka shkuar në Bullgari për vizitë tek prindërit e saj dhe që nga atëherë nuk është kthyer. Në nëntor të vitit 2016 unë kam

shkuar ne Bullgari që ta takoj të paditurën, por të njëjtën nuk mundur që ta takoj dhe prindërit e saj nuk kanë pasur njohuri se ku jeton e njëjta.

Gjykata deklarimit të paditësit ia fali besimin e plotë, pasi që i njëjti gjatë dhënies se deklaratës ishte i sigurtë dhe deklarimet e tij ishin në përputhje me provat e tjera.

Gjykata duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së duke çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se palët ndërgjyqëse pranë organit kompetent kanë lidhur kurorë me dt.15.04.2016 (fakt ky i vërtetuar nga çertifikata e martesës). Paditësi me të paditurën pas martesës kanë jetuar në shtëpinë e paditësit për një javë dhe më pas e njëjta ka shkuar në vendlindjen e saj për vizitë tek prindërisht dhe më pas nuk është kthyer tek paditësi dhe nga ajo kohë ky i fundit nuk ka pasur asnjë kontakt me të paditurën.

Nga gjendja faktike e spjeguar si më lartë, përkatësisht duke vërtetuar faktin se paditësi me të paditurën jeten faktike e ka ndërprerë nga muaji Tetor i vitit 2016, në njërën anë kurse në anën tjetër duke u bazuar në nenin 69.2 të LFK-së u vendos sin ë pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi (si në pikën II të këtij aktgjykimi) që perfaqesuesit te perkohshem I. Th, av. nga Gjilani , nga depozita civile do'ti paguhet shuma totale prej 239 €, edhe ate shuma prej 104 € per pergjigjje ne padi dhe shumen prej 135 € per një seance duke u bazuar në nenin 81.2 të LPK-së , pasi që paditësi me depozitë civile për shpenzimet e përfaqësuesit të përkoshëm, ka deponuar shumën 374.40€<sup>1</sup>, kurse u vendos që paditesit, perkatesisht te autorizuarit te tij nga depozita civile e si më lartë të njëjtit ti kthehet shuma prej 131.40 €, pasi që siç tham më lartë përfaqësuesit të përkoshëm i është paguar një séance dhe përgjegja në padi edhe atë duke u bazuar të TA-në.

Prandaj, nga të lartcekurat, duke përfshirë gjendjen faktike, dispozitat ligjore dhe bindjen e lirë si dhe bazuar në nenet 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.732/19, dt.15.10.2020**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Venhar SALIHU

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa eventuale në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

---

<sup>1</sup> Gjykata ka llogaritur dy seanca dhe shpenzimet për përgjegje në padi, por është mbajtur vetëm një seancë.